



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.03.2021, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Besim Sherifit, Mehedin Pacollit, Arben Mavriqit dhe Agim Dreshajt.
- II. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale, nr. 01414-3, me sipërfaqe 561m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914050-01414-3-0, Zona kadastrale, Matiçan, me destinim ndërtim sipas Planit rregullues "Mati 1", i miratuar me Vendimin, nr. 01 nr. 35-642, dt. 01.04.2010, si dhe Vendimi për ndryshim dhe plotësim të Planit rregullues "Mati1", i miratuar me Vendimin, nr. 01 nr. 031-1678, dt.20.07.2011, kurse pronat e paluajtshme që merren nga ky këmbim, janë parcelat kadastrale nr. 00618-0, sip. 339m², nr. 00619-0, sip.190m² dhe nr.00620-0, sip.32m² Zona kadastrale Matiçan, Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914050-00618-0, në pronësi të Besim Sherifit, nr. P-71914050-00619-0, në pronësi të Mehedin Pacollit dhe P-71914050-00620-0, në pronësi të Arben Mavriqit dhe Agim Dreshajt, me destinim rrugë, e planifikuar sipas Planit rregullues "Mati 1", i miratuar me Vendimin nr. 01nr.35-642, dt.01.04.2010.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues "Mati 1", si dhe Vendimi për ndryshim dhe plotësim të Planit rregullues "Mati1", i miratuar me Vendimin nr. 01 nr. 031-1678, dt.20.07.2011, në Prishtinë.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.

- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Arsyetim

Drejtorja e Urbanizmit me Vendimin për përcaktimin e kushteve ndërtimore, 05. nr.350/02-160721/19, dt.18.09.2020, ka dhënë Pëlqimin për këmbimin e pjesës kadastrale nr. 1414-3, sip.561m², ZK, Matiçan, në pronësi të Komunës së Prishtinës. Pjesët e parcelave nr. 618-0, me sip. 339m², në pronësi të Besim Sherifit, nr. 619-0, me sip.190m², në pronësi të Mehedin Pacollit dhe 620-0, me sip. 32m², në pronësi të Arben Mavriqit dhe Agim Dreshajt, ZK, Matiçan, Prishtinë. Pjesa e parcelës nr.1414-3, me sip. 561m², gjendet në kuadër të bllokut urban "A 8", ngastra "A" të Planit rregullues "Mati 1" në Prishtinë dhe pjesët e parcelave me nr.618-0, me sip. 339m², 619-0, me sip.190m² dhe nr. 620-0, me sip. 32m², Zona Kadastrale Matiçan, me destinim rrugë dhe gjelbërim, planifikuar sipas Planit rregullues "Mati 1" Prishtinë.

Propozimi për inicimin e këmbimit të parcelës/ave të tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues "Mati 1" në Prishtinë, Vendimin për caktimin e kushteve ndërtimore, 05. nr. 350/02-160721/19, dt. 18.09.2020. Pjesa e parcelës nr.1414-3, Zona kadastrale, Matiçan, shtrihet në zonë të planifikuar për ndërtim të lartë, ndërsa pjesët e parcelave nr. 618-0, 619-0 dhe 620-0, Zona kadastrale, Matiçan, Prishtinë, shtrihen në infrastrukturë publike - rrugë dhe gjelbërim i planifikuar.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private, është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25, të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019).

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.

Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/01-46038/21, më 11.03.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

